

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. 305 / REP

NR. 112 / KOL



KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Sot më datë 16.02.2018 (dymijë e tetembëdhjete), para meje noterit publik, Arian A. Mërkuri, Anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, me zyrë në Rr. "Reshit Çollaku", P."Shallvaret", Shk.4, ap.41, u paraqitën personalisht palët kontraktuese të cilët më kërkuan hartimin e kësaj kontrate me kushtet e mëposhtme:

Palët kontraktuese

z. Gentian Ferhati, i biri i Bashkimit, lindur ne Shkoder, i datelindjes 04.06.1978, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i pajisur me dokument identiteti Leternjofitim me Nr.028374453 dhe Nr.personal H80604079N, leshuar me 27.01.2010., ne cilesine e ortakut te vetem te **Shoqerise "Gentian Ferhati" shpk** e pajisur me NIPT L72414030K, me seli ne Rruga "Ibrahim Rrugova", Ndertesa 22, Hyrja 57, Ap.10, Njesia Administrative Nr.10, Tirane.
nga këtu e më poshtë referuar si "SHITËSI"

z. Enver Mehmeti, i biri i Skenderit, lindur ne Durres me 22.08.1962, banues ne Tirane, Rr."Elbasanit" madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar prej leternjofitim Nr.G20822071P, leshuar me date 01.06.2010, *nga këtu e më poshtë referuar si "BLERESI"*

HYRJE

Shoqëria "Gentian Ferhati" shpk, shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e pajisur me NIPT L72414030K me seli ne Rruga "Ibrahim Rrugova", Ndertesa 22, Hyrja 57, Ap.10, Njesia Administrative Nr.10, Tirane, me kapital 100,000.00 lek (njeqindmije, lek) me Ortak te vetem z.Gentian Ferhati, me 100% pjese te kuotave te kapitalit e licensuar nga AMA me vendimin Nr.19 date 31.01.2018, me emrin "Tv Wedding Channel".

PERMBAJTJA E KONTRATES

Shoqëria "Gentian Ferhati" shpk, eshte regjistruar ne QKR, e pajisur me NIPT L72414030K.

Me vendim Nr.1 date 08.02.2018, të ortakut të vetëm të shoqerise " Gentian Ferhati" shpk, eshte vendosur shitja e kuotave ne masen 70%(shtatedhjet) pergind nga z. Gentian Ferhati, per z. Enver Mehmeti.

Shitesi, eshte ortak i vetem qe zoteron 100% te kuotave te shoqerise "Gentian Ferhati" shpk. dhe eshte plotesisht dakord qe ti shese me vullnetin tij të lire dhe të plote bleresit, 70%(shtatedhjet perqind) të kuotave zoteruese ne kapitalin e shoqerise "Gentian Ferhati" shpk.

Nga ana e vet **Bleresi**, eshte plotesisht dakord qe te bleje 70% (shtatedhjet)perqind te kuotave te shoqerise " Gentian Ferhati " shpk.

ÇMIMI I SHITJES SE KUOTAVE DHE MENYRA E PAGESES.

Vlera e shitjes se kuotave ne masen 70%(shtatedhjet perqind) nga shitesi, do te jete e barabarte me nje vlere prej 10.000,00 Euro(dhjetemije euro), vlere kjo me te cilen jane vleresuar paketa e kuotave te shitura nga ana e ortakut te shoqerise " Gentian Ferhati" shpk, per te cilen eshte rene dakord edhe nga ana e pales blerese z.Enver Mehmeti.

Pagesa ne shumen e mesiperme eshte bere jashte zyres noteriale dhe ne menyren e pageses cash ne dore.

MENYRA E KALIMIT TE PRONESISE SE KUOTAVE.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, shitesi humbet pronesine 70%(shtatedhjet perqind), te kuotave ne kapitalin e shoqerise se mesiperme, duke mos patur ne te ardhmen asnje pretendim pronesie.

Bleresia me nenshkrimin e kesaj kontrate behet pronar i 70%(shtatedhjet perqind), te kuotave ne shoqerine " Gentian Ferhati" shpk dhe mer persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe lindin nga zoterimi i ketyre kuotave.

Keshtu, me perfundimin e ketij transaksioni shitje, do te kemi kete gjendje te zoterimit te kuotave ne shoqerine " Gentian Ferhati" shpk :

Bleresi, **Enver Mehmeti**, do te zoteroje 70%(shtatedhjet perqind), te kuotave te shoqerise " Gentian Ferhati" shpk. Nga ky moment z. Enver Mehmeti do te jete Ortak i shoqerise "Gentian Ferhati" shpk

2.Shites, Gentian Ferhati, pas ketij trasaksioni do te zoteroje 30%(tridhjetepaqind) te kuotave ne shoqerine "Gentian Ferhati" shpk.

DETYRIMET E SHITËSIT

Shitësi do të marrë të gjitha masat për të garantuar përmbushjen e të gjitha detyrimeve të marra prej tyre në bazë dhe për zbatim të kësaj kontrate.

Shitësi do të paguajë të gjitha detyrimet/taksat e parashikuara prej legjislacionit Shqiptar në lidhje me këtë kontratë.

DETYRIMET E BLERËSIT

Blerësi ka paguar çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në kete kontrate.

Pala blerese ka marre ne dorzim kuotat dhe e ka likuduar palen shitesse kundrejt cmimit te percaktuar me siper, duke mos patur asnje verejtje sipas dokumentit ligjor.

DETYRIMET E PALEVE

Palët ne këtë kontratë, i do të marrin të gjitha masat për të regjistruar transferimin e kuotave objekt i kësaj kontrate.


KLAUZOLA SHITESI TE KONTRATES

Kjo kontratë hartohet në 4 (kater) kopje autentike nga të cilat një qëndron në zyrën e noterisë, një kopje duhet të depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), dhe nga një kopje e merr secila palë.

Termet e kontrates, pasi u redaktuan prej meje noterit, iu bene te njohura paleve kontraktuese, te cilet e nenshkruan ate me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ne pranine time

Kjo kontratë pasi iu lexua me zë të lartë Shitësit dhe Blerësi, deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj, ata më deklaruan që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë, u nënshkrua prej tyre në praninë time dhe unë noter i vërtetoj atë në bazë të ligjit.

SHITESI


Gentian Ferhati


BLERESI

ENDER MEHMEDI


NOTER

ARIAN A. MËRKURI

Arian A. Mërkuri


Me seli ne Tirane,

Rr. "Ibrahim Rugova", Nderresa 22, Hyrja 57, Ap.10, Njesia Administrative Nr.10.

SHOQERIA "GENTIAN FERHATI" SH.P.K

VENDIM NR.1

I ORTAKUT TE VETEM

Sot me date 08.02.2018, une ortaku i vetem i Shoqerise "Gentian Ferhati" sh.p.k me seli ne Tirane, Rr. "Ibrahim Rugova", Nderresa 22, Hyrja 57, Ap.10, Njesia Administrative Nr.10, e miratuar si person juridik me NIPT L72414030K, me ortak te vetem dhe Administrat z. Gentian Ferhati, me zoterim 100% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie.

Konforme Ligjit Nr.9901, date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

KONSTATOJ SE:

Ne mbledhjen e asamblese se ortakut te vetem u diskutuan problemet e rendit te dites lidhur me shitjen e 30% te kuotave te kapitalit dhe aktivitetit te shoqerise per kete:

VENDOSA:

- 1- Miratimin e shitjes se 70% kuotave te shoqerise "Gentian Ferhati" shpk nga Ortaku i Vetem z Gentian Ferhati, per z. Enver Mehmeti.
- 2- Ndryshimin e emrit te shoqerise nga Shoqeria "Gentian Ferhati" shpk ne Shoqeria "Premium Media" SHPK

Pra Shoqeria "Premium Media" shpk, ketej e tutje do te jete me dy Ortake :

1. Enver Mehmeti, i cili do te zoteroje 70% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie.
2. Gentian Ferhati, i cili do te zoteroje 30% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie.

Administratori i kesaj shoqerie ketej e tutje, do te vazhdoje te jete per nje afat 5 vjecar z. Gentian Ferhati.

ORTAK I VETEM

Gentian Ferhati


GENTIAN FERHATI SH.P.K
Sh.p.k.
NIPT: L 72414030K
Tirane - Albania

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L72414030K	
2. Data e Regjistrimit	14/12/2017	
3. Emri i Subjektit	GENTIAN FERHATI SHPK	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	12/12/2017	
6. Kohëzgjatja	Nga: 12/12/2017	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga "Ibrahim Rugova", Ndertesë 22, Hyrja 57, Apartamenti 10, Njesia Administrative Nr. 10	
8. Kapitali	100,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Veprimtari audiovizive, prodhim transmetim dhe ritransmetim i programeve audiovizive. Për kryerjen e veprimtarisë së saj, shoqëria do të hapë njësi prodhuese, grumbulluese, magazinuese, përpunuese, shërbimi e tregtimi, duke bashkëpunuar me persona fizikë e juridik vendas dhe të huaj. Përveç veprimtarive të parashikuara më lart, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë çdo veprimtari që do të konsiderohet nga Asambleja e Ortakëve si e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin Shqiptar.	
10. Administratori/ët	Gentian Ferhati	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 12/12/2017	Deri: 12/12/2022
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	Gentian Ferhati	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		

13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: GENTIAN FERHATI SHPK Telefon: 0693120307
15. Statusi:	Aktiv

Lista e Dokumenteve:

Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)

Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)

Akti i themelimit

Regjistrimi Fillestar:

Datë: 15/02/2018

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga Web